

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                             |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Thoma Gëllçi: UÇK-ja nuk mbrohet me statute në "Facebook"                                                                                                                                   |
| ADRESA  | <a href="https://newsbomb.al/oped/thoma-gellci-uk-ja-nuk-mbrohet-me-statute-ne-facebook-i401465">https://newsbomb.al/oped/thoma-gellci-uk-ja-nuk-mbrohet-me-statute-ne-facebook-i401465</a> |
| BURIMI  | newsbomb.al                                                                                                                                                                                 |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                      |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 17 shtator 2026, 14:45:03 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 14:42:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | f59c600269fbbb18c7edf7a7ff36f3212037e099afe02f21dcaddde888c818ad |
| TEKSTI     | c22b21863ef71e339d0e9c216f84ba50eedeee02a1ecac7856d6689c1a0e00cb |
| PAMJA      | 935edb7fe7dc714d738158a4875c67c5311edcd6ef5ea9dd3444eb42fb7c6930 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 2dec4dc9ab5009d5f73bcd938f3f87440461c8bf443a4ae1c1d4076be4c73e2                                 |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | dc0b234c87b6bef6f484ef22e44d5789ea8bfa692c7eb14dae36a548c590e2a2                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2dec4dc9ab5009d5f73bcd938f3f87440461c8bf443a4ae1c1d4076be4c73e2>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



12 numrat e parë FALAS!  
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë &amp; Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



## Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

OpEd

17 Shtator 2026, 16:42

## Thoma Gëllçi: UÇK-ja nuk mbrohet me statuse në "Facebook"



Shkruar nga Newsbomb



Autori i artikullit, Thoma Gëllçi

## Nga Thoma Gëllçi

Pas vendimit të Hagës për Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin, Facebook-u shqiptar hyri menjëherë në gjendje gatishmërie luftarake. U nxorën nga magazinat fotografitë e UÇK-së, flamujt, shqiponjat, hartat e Kosovës dhe të gjitha ato fjalë të mëdha që, në raste të tilla, Facebook-u i prodhon më shpejt se një shtab ushtarak prodhon urdhra.

Brenda pak orësh u krijuan batalionet e statuteve, brigadat e profileve dhe divizionet e komenteve. Secili mori pozicionin e vet. Njëri ndryshoi fotografinë e profilit. Tjetri vuri emblemën e UÇK-së. Një i tretë shkroi me shkronja të mëdha se historia nuk gjykohej. Një i katërt shpalli tradhtar cilindo që nuk kishte bërë ende një postim. Patriotizmi, si zakonisht, filloi të matej me madhësinë e posterave.

Kryeministri i Shqipërisë e dha shembullin i pari. Ndryshoi menjëherë dekorin e Facebook-ut. Në kopertinë vendosi shqiponjën dykrenare, ndërsa në postim Evropën të rrethuar me tela me gjemba, si një shenjë se Evropa tashmë ishte nën thundrën e nazizmit. Sipër shkroi një fjalë të vetme, me shkronja të kuqe: MARRE. Pas kryeministrit një tufë e madhe me ministra dhe ministresha i mbushën profilet e tyre me mallkime për Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë që dhanë atë vendim që dhanë!

Edhe kryetari i opozitës Sali Berisha nuk mund të mbetej prapa. Me postimet e tij jo vetëm që tregoi se këtë vendim ai e kishte parashikuar disa vjet përpara, por gjeti rastin

## Revista



Abonohu tani dhe lexoje &gt;

## Lajmet e fundit



## Aktualitet

U fut për t'u larë në det por zemra e tradhëtoi, ndërron jetë pushuesi në Vellipojë



## Aktualitet

Zegjine Çausi i nxori foton me lule dhe e lumtur krah dajës së saj. Merta Gremaj tregon si qëndron e vërteta: Kurrë e kurrës, ai më kërcënoi...

Zbulu më shumë artikuj &gt;

t'i thoshte edhe Edi Ramës se "po derdhte lot krokodili".

Dhe kështu diplomacia shqiptare kreu detyrën. Ministria e Jashtme mund të vazhdonte punën e zakonshme, ekspertët mund të rrinin të qetë dhe juristët të mos shqetësoheshin. Shqiptarja ishte vendosur në pozicion luftarak, Evropa kishte marrë qortimin dhe algoritmi i Facebook-ut ishte njoftuar zyrtarisht për qëndrimin e Republikës së Shqipërisë.

Problemi i vetëm është se Gjykata e Apelit në Hagë nuk ka butonin Like.

Vendimi i 16 shtatorit është vendim i shkallës së parë. Gjykata i shpalli fajtorë për krime lufte, ndërsa nuk i shpalli fajtorë për krime kundër njerëzimit, sepse nuk konsideroi të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm ekzistencën e një sulmi të përhapur ose sistematik kundër një popullsie civile.

Ky është realiteti juridik. Nuk na pëlqen. E konsiderojmë vendimin të gabuar, të padrejtë, të ekzagjeruar apo të pambështetur siç duhet në prova. Por për fatin e keq të patriotizmit dixhital, këto konsiderata tani duhet të shndërrohen në argumente juridike.

Sepse apeli nuk do të hapë Facebook-un për të parë sa shqiptarë vendosën dje emblemën e UÇK-së. Nuk do të numërojë flamujt në Prishtinë. Nuk do të kontrollojë sa politikanë në Tiranë thanë "turp". Nuk do të bëjë as matjen se kush e shkroi "MARRE" me shkronja më të mëdha.

Apeli do të hapë aktgjykimin. Duhet gjetur ku ka gabuar gjykata, nëse ka gabuar. Te provat, te dëshmitë, te lidhja e secilit prej të dënuarve me veprimet për të cilat është shpallur fajtor, apo te masa e dënimit. Kjo është puna e avokatëve dhe e ekspertëve, jo e komenteve në Facebook.

Dhe pikërisht këtu mund të hyjnë në punë Kosova dhe Shqipëria. Jo duke i treguar Hagës sa të zemëruar jemi, por duke ndihmuar mbrojtjen me dokumente, ekspertë, arkiva, studime dhe juristë të mirë. Nëse ekziston një dokument që ndihmon çështjen, duhet gjetur. Nëse duhet një ekspert i së drejtës ndërkombëtare, duhet marrë. Nëse duhet paguar, duhet paguar.

Kjo është më pak spektakolare se një flamur në profil, apo sharje për "Evropën kjo kurva e motit", por ka një avantazh të vogël: mund të vlejë në gjykatë. Gotovina kishte marrë 24 vjet burg. Markac 18. Perishic 27. Jean-Pierre Bemba 18. Asnjëri nuk doli nga burgu sepse vendi i tij organizoi mitingun më të madh apo sepse Facebook-u u mbush me flamuj. Vendimet u goditën aty ku mund të goditet një vendim gjykatë: te prova, standardi juridik dhe arsyetimi. Te Gotovina ra kriteri teknik mbi goditjet e artilerisë dhe bashkë me të një pjesë vendimtare e çështjes. Te Perishic u rrëzua lidhja juridike mes ndihmës së dhënë dhe krimeve. Te Bemba u rrëzua mënyra si ishte ndërtuar përgjegjësia e komandantit. Tre procese të ndryshme, por me një mësim të përbashkët: një vendim gjykatë nuk rrëzohet duke bërë titur më fort. Duhet gjetur vendi ku vendimi nuk qëndron.

Ndërkohë, politika e Kosovës ka filluar ta bëjë atë që di të bëjë më mirë: ta fusë edhe Hagën në sherret e veta të brendshme. Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi rrezikojnë të kthehen në argument kundër Albin Kurtit, ndërsa UÇK-ja në një lloj certifikate patriotizmi që partitë ia japin vetes dhe ia heqin kundërshtarit.

Kjo mund të vlejë në Prishtinë. Në Hagë vlen zero.

As bllokimi i institucioneve nuk e ndihmon këtë punë. Përkundrazi. Për të ndihmuar një proces kaq të madh duhen institucione që punojnë, arkiva që hapen, administratë që përgjigjet dhe para që miratohen. Është pak e çuditshme të thuash se po mbron njerëzit që luftuan për shtetin e Kosovës duke bllokuar pikërisht shtetin e Kosovës.

Ne nuk heqim dorë nga zakoni i vjetër i politikës shqiptare: sa herë mungon argumenti, nxirret patriotizmi.

Secili prej nesh bëhet gjykatës. Jo i vetes. I të tjerëve. Ky është patriot. Ky tjetri është tradhtar. Ky e do UÇK-në. Ai tjetri nuk e do. Ky postoi fotografinë. Ai heshti. Ky tha "turp". Ai tha se duhet lexuar vendimi dhe për këtë arsye menjëherë bëhet i dyshimtë.

Qëndrimi ndaj procesit penal nuk është test besnikërie kombëtare. Historia e UÇK-së nuk varret nga një aktgjykim dhe një aktgjykim nuk rrëzohet duke resituar historinë e

UÇK-së.

Katër të dënuarit tani kanë një problem shumë konkret: një vendim gjykate. Përballë tij duhen prova, ligj dhe argument.

Ne kemi bindjen se dënimet janë të tepruara. Por nuk mjafton të themi bindjen tonë. Kjo duhet treguar në gjykatë me rastet analoge. Nëse një dëshmi është marrë gabim, duhet provuar nga dosja.

Nëse përgjegjësia e njërit prej tyre nuk është lidhur siç duhet me një krim, aty duhet goditur vendimi.

Kjo nuk është aq romantike sa një miting. Nuk është aq fotogjenike sa një flamur. Nuk prodhon aq shumë duartrokitje nga përkrahësit dhe militantët politikë që mezi presin të të krehin bishtin.

Por ama vetëm kjo puna pa britma, me dokumente dhe dëshmi, me ekspertizë dhe shkresa, vetëm kjo mund ta ndryshojë vendimin.

Është vonë sot që të diskutojnë pse u krijua Gjykata Speciale, kush e votoi, kush bëri presion, kush gaboi atëherë dhe kush po përpiqet të lajë duart sot. Ka material për vite të tëra emisionesh televizive. Por kjo është një histori tjetër.

Historia që ka sot përpara Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi quhet apel. Dhe për këtë nuk nevojitet një tjetër luftë në Facebook, as një luftë e re mes partive në Prishtinë. Nevojiten avokatë të mirë, ekspertë të mirë dhe institucione që bëjnë punën e tyre.

Facebook-u mund të vazhdojë ndërkohë mobilizimin. Ka flamuj sa të duash, shqiponja me bollëk dhe rezerva të pafundme të fjalës "tradhtar".

## Sondazh

Poll

## Lexo gjithashtu



🕒 E Mërkurë 12:41 Adri Nurellari

## Kur agresori shkruan dosjen në Hagë dhe viktima fle mbi dafina: Nga fitorja e luftës te disfata e kujtesës



OpEd

Nota katër në arsim: Pse katër universitetet e reja janë katër dështime të paralajmëruara

E Hënë 10:03

OpEd

Ramë Pagëzimori, Rilindishtja dhe arti i qeverisjes me fjalor

E Diel 16:23 Adri Nurellari



E Martë 13:45

## Një moment vendimtar për Shqipërinë



OpEd

Një dritare mundësie për Tiranën: Pse "Jo"-ja e Islandës ndaj BE-së favorizon integrimin e Shqipërisë

E Diel 18:33



OpEd

Elvis Karaj, ikja e një njeriu që jetoj për të tjerët

E Martë 14:31 Anila Basha



E Martë 11:33

## Kurthi i Kurtit për Republikën: Pse fitorja në zgjedhje nuk të bën pronar të shtetit





OpEd

### Ylli Manjani: Dy argumente absurde për kundërshtinë e reformës territoriale

E Diel 13:06



OpEd

### Natyra si Atdhe: Parathënie për një patriotizëm mjedisor shqiptar

E Shtunë 09:21



OpEd

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.